



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:232352

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05755409

C.nr.436/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.T nga Vushtrria, rruga ... , të cilin e përfaqëson me autorizim K.B avokate nga Vushtrria, kundër të paditurit B.Sh nga Vushtrria, rruga ..., me objekt kontesti kompensim i dëmit jo material për shkak të shpifjes, me vlerë të kontestit 2,000.00 € (dymijë euro), pas përfundimit të shqyrtimit kryesor e publik me datë 16.05.2024, në prezencë të përfaqësueses së paditësit dhe të paditurit, me datë 30.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit H.T nga Vushtrria, rruga

II. DETYROHET i padituri B.Sh nga Vushtrria, rruga ..., që në emër të dëmit jo material për shkak të shpifjes së bërë me datë 21.07.2018, paditësit H.T , t'ia paguaj shumën prej 1,300.00 €, (njëmijë e treqind euro), me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e nxjerrjes së aktgjykimit (30.05.2024), e deri në përmbushjen definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 404.00 €, (katërqind e katër euro), të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. REFUZOHET pjesërisht si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësit H.T , kundër të paditurit B.Sh, për kompensimin e dëmit jo material për shkak të shpifjes, përtej shumës së aprovuar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën prej 700.00 €, (shtatëqind euro).

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësi H.T nga Vushtrria, rruga ... , përmes të autorizuarës së tij, me datë 28.09.2018, ka parashtruar padi për kompensimin e dëmit jo material për shkak të shpifjes, kundër të paditurit B.Sh nga Vushtrria, rruga Ka theksuar se i padituri me datë 21.07.2018, ka bërë shpifje ndaj paditësit në atë mënyrë që në televizionin ... në edicionin e lajmeve të këtij mediumi të përgatitur nga gazetarja N.R, në storien “Fqinjët Në Vushtrri në hall me njëri tjetrin”, i padituri është ankuar në fqinjin e tij-familjen Sh... dhe në mes tjerash ka deklaruar se “vetë dhëndri i tij H.T më ka thënë t’i ski çka na bën, se unë e kam djalë të tezes Sh.M , është fakt se ky më ka thënë edhe më ka kërcënuar edhe në market, kur kam shkuar për blerë gjëra ushqimore për fëmijë, aty më ka pritur edhe më ka përcjellë deri jam dalë prej aty dhe më ka thënë unë i kam njerëzit e mi në polici dhe ti nuk mundesh kurrjë me bë”.

Ka shtuar se i padituri me në këtë mënyrë ka përhapur fakte të pavërteta ndaj paditësit, të cilit ia ka cenuar vlerat themelore personale, ia ka cenuar imazhin e tij dhe të familjes së tij, ngase paditësi ka familje e cila është e njohur në Vushtrri, se paditësi ka një biznes individual që e mbanë familjen,, ndërsa me përhapjen e fakteve të pavërteta nga i padituri, ka ndikuar edhe në imazhin e tij. Nga këto arsye gjykatës i ka propozuar që me aktgjykim të vërtetohet se i padituri ka shpifur me deklarimin e tij dhe të detyrohet i njëjti që paditësit, në emër te kompensimit të dëmit jo material për shkak të shpifjes, t’ia paguaj shumën prej shumën prej 2,000.00 €, (dymijë euro). Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Paditësi, nëpërmjet të autorizuarës së tij edhe përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka mbetur pranë padisë dhe kërkesë padisë, duke kërkuar nga gjykata që të detyrohet i padituri që paditësit, në emër të dëmit jo material- satisfaksionit, t’ia kompensojë shumën prej 2000 euro dhe shpenzimet e procedurës dhe atë: në emër të padisë shumën prej 104 euro, në emër të taksës gjyqësore shumën prej 30 euro dhe në emër të përfaqësimit në dy seanca shumën prej nga 135 euro për secilën seancë.

I padituri në përgjigje në padi, deklarimeve në seancë dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetimin se asnjëherë nuk ka shpifur për paditësin, se deklaratën në media-televizionin ... me datë 21.07.2018, e ka dhënë pasi që i ka dhënë deklaratat në polici dhe në prokurori dhe këto deklaratat i ka dhënë sepse ka qenë i frikësuar nga paditësi dhe personat M.Sh , B.Sh1 dhe B.Sh2, të cilët sipas pretendimit të tij e kanë sulmuar fizikisht dhe me mjete të forta me datë 13.07.2017, po ashtu se ia kanë sulmuar djalin e tij L.Sh.

Po ashtu ka theksuar se paditësi H.T ka qenë person i dyshuar së bashku me miqtë e tij, se ndaj tyre janë zbatuar hetime dhe ka pasur edhe dënime të shqiptuara. Nga këto arsye, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për përgjigje në padi shumën prej 104 euro.

Gjendja faktike e vërtetuar

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike administroi provat si: Ankesa e paraqitur nga paditësi me datë 24.07.2018, e titulluar ankesë ndaj shpifjes në televizionin ..., Vendimi i Komisionit të Pavarur të Mediave, rasti nr.2018/172, ref:1809/987/KPM/mf i datës 06.09.2018, Komunikimi elektronik i datës 13.09.2018, ndërmjet paditësit dhe zyrtarit të KPM-së A.D, Komunikimet elektronike të datës 24.07.2018 të dorëzuara nga paditësi bashkë me padi, Certifikata nga evidenca penale e datës 24.07.2018, Aktgjykimi me urdhër ndëshkimor i GJTHM- Dega në Vushtrri, P.nr.476/19 i datës 14.01.2020, Aktgjykimi me urdhër ndëshkimor i GJTHM- Dega në Vushtrri, P.nr.476/19 i datës 25.06.2021, Kërkesa e të paditurit B.Sh drejtuar Prokurorisë Themelore në Mitrovicë me datë 17.07.2018, Raporti i Spitalit Sheikh Zayed në Vushtrri nr. rendor 3449 i datës 13.07.2018, CD-ja e cila përmban linkun ...

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Nuk ishte kontestuese se i padituri B.Sh , me datë 21.07.2018, në televizionin ... në edicionin e lajmeve të këtij mediumi të përgatitur nga gazetarja N.R, në storien “Fqinjët Në Vushtrri në hall me njëri tjetrin”, ka deklaruar se “vetë dhëndri i tij H.T më ka thënë t’i ski çka na bën, se unë e kam djalë të tezes Sh.M , është fakt se ky më ka thënë edhe më ka kërcënuar edhe në market, kur kam shkuar për të blerë gjëra ushqimore për fëmijë, aty më ka pritur edhe më ka përcjellë deri jam dalë prej aty dhe më ka thënë unë i kam njerëzit e mi në polici dhe ti nuk mundesh kurrë me bë”, fakt të cilin e ka pohuar vet i padituri, por sipas tij, nuk ka pasur qëllim që të shpif ndaj paditësit, por ka qenë i frikësuar dhe i kërcënuar nga paditësi dhe familja Sh...

Kontestuese mes palëve ishte baza juridike e kërkesëpadiës, respektivisht nëse deklarimi i të paditurit ka përmbajtje shpifëse dhe ndaj paditësit – gjë që do të përbënte bazë për kompensimin

e dëmit. Padiësi ka pretenduar se i padituri me deklarimin e lartcekur, ka shpifur duke nxjerrë dhe përhapur informata të pavërteta me çka i janë cenuar vlerat themelore personale dhe imazhi i tij, ndërsa sipas të paditurit, deklarimi i tij nuk ka pasur qëllim të shpifjes ndaj padiësit, por deklaratën e ka dhënë sepse ka qenë i frikësuar dhe i kërcënuar nga padiësi dhe familja Sh...

Nga ankesa e paraqitur nga padiësi me datë 24.07.2018, gjykata vërtetoi se padiësi H.T , është ankuar në televizionin ..., se nuk iu është dhënë mundësia për tu deklaruar sa i përket pretendimeve të të paditurit, e përmes së cilës ka kërkuar që ti jepet mundësia e demantimit të deklarimit të të paditurit dhe që ky medium ti kërkoj falje publike padiësit dhe që storja që përmban deklarimin e të paditurit, të hiqet nga rrjetet sociale.

Nga Vendimi i Komisionit të Pavarur të Mediave, rasti nr.2018/172, ref:1809/987/KPM/mf i datës 06.09.2018, gjykata vërtetoi se ky komision i ka shqiptuar vërejtje televizionit ...-si palë përgjegjëse dhe e ka obliguar të transmetoj reagimin e palës ankuese këtu padiësit H.T .

Nga komunikimi elektronik i datës 13.09.2018, ndërmjet padiësit dhe zyrtarit të KPM-së A.D, gjykata vërtetoi se padiësit i është dërguar Vendimi i Komisionit të Pavarur të Mediave, rasti nr.2018/172, ref:1809/987/KPM/mf i datës 06.09.2018.

Nga komunikimet elektronike të datës 24.07.2018 8, të dorëzuara nga padiësi bashkë me padi, gjykata vërtetoi se janë komunikime ndërmjet disa personave si H.B, D.B e disa të tjerë, por të njëjtat nuk kishin ndonjë relevancë sa i përket pretendimeve të padiësit lidhur me shpifjen nga i padituri.

Nga certifikata nga evidenca penale e datës 24.07.2018, gjykata vërtetoi se ndaj padiësit nuk ka qenë duke u zhvilluar procedurë penale dhe nuk ka qenë i dënuar.

Nga Aktgjykimi me urdhër ndëshkimor i GJTHM- Dega në Vushtrri, P.nr.476/19 i datës 14.01.2020, gjykata vërtetoi se të akuzuarit B.Sh1, B.Sh2 dhe M.Sh , janë shpallur fajtor për veprën penale “Kanosje” sipas KPRK-së, ndaj të dëmtarit-këtu të paditurit B.Sh dhe janë dënuar secili me nga 500 euro gjobë.

Nga Aktgjykimi me urdhër ndëshkimor i GJTHM- Dega në Vushtrri, P.nr.476/19 i datës 25.06.2021, gjykata vërtetoi se të akuzuarit B.Sh1, B.Sh2 dhe M.Sh , janë shpallur fajtor për veprën penale “Lëndim i lehtë trupor” sipas KPRK-së, ndaj të dëmtarit-këtu të paditurit B.Sh dhe janë dënuar secili me nga 200 euro gjobë.

Nga kërkesa e të paditurit B.Sh drejtuar Prokurorisë Themelore në Mitrovicë me datë 17.07.2018, gjykata vërtetoi se i padituri ka kërkuar mbrojtje të shëndetit dhe të jetës për të dhe familjen e tij, ku ka pretenduar se ka qenë i sulmuar nga paditësi H.T dhe B.Sh1, B.Sh2 dhe M.Sh .

Nga Raporti i Spitalit Sheikh Zayed në Vushtrri nr. rendor 3449 i datës 13.07.2018, gjykata vërtetoi se i padituri B.Sh , ka marr trajtim mjekësor për shkak të lëndimeve të pësuar me datë 13.07.2018.

Nga audio dhe video-CD-ja e cila përmban linkun ..., gjykata vërtetoi se i padituri, ka shprehur shqetësime ndaj familjes Sh... dhe ka dhënë deklaratën: “vetë dhëndri i tij H.T më ka thënë t’i ski çka na bën, se unë e kam djalë të tezes Sh.M , është fakt se ky më ka thënë edhe më ka kërcënuar edhe në market, kur kam shkuar për të blerë gjëra ushqimore për fëmijë, aty më ka pritur edhe më ka përcjellë deri jam dalë prej aty dhe më ka thënë unë i kam njerëzit e mi në polici dhe ti nuk mundesh kurrjë me bë”, e që sipas paditësit, i padituri ka shpifur ndaj tij.

Gjykata gjeti se në rastin konkret, pjesërisht themelësia e kërkesëpadisë së paditësit, përveç bazës faktike, buron edhe nga baza juridike përkatësisht faktet e provuara në tërësi subsumohen në normën materialo-juridike nga e cila edhe del pasoja e caktuar juridiko-civile.

Baza ligjore

Gjykata, gjeti se në rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat e Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes (tutje LCSHF - Ligji nr. 02/L-65), pasi që padia e paditësit ka të bëjë me kërkesën për kompensimin e dëmit në emër të shpifjes. Me nenin 3 pika a), të këtij ligji përcaktohet se “*Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër*”. Në pikën b) të po këtij neni përcaktohet se “*Fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese*”. Në pikën c) përcaktohet se “*Publikimi nënkupton përhapjen e shprehjes me shkrim ose gojarisht, përmes mediave të shkruara ose transmetuese apo përmes mjeteve tjera, shprehje të cilën e ka lexuar ose dëgjuar së paku një person i tretë*”,

Tutje, neni 5 par.1 i ligjit të lartcekur përcakton se “*Një person është përgjegjës për shpifje ose fyerje në qoftë se ai/ajo ka kryer ose përhapur shprehjen e shpifjes ose fyerjes përveç nëse është*

konstatuar njëra nga përjashtimet e përgjegjesisë në pajtim me këtë Ligj". Me nenin 6 par. 1 të ligjit përcaktohet se *"Në të gjitha veprat për shpifje dhe fyerje, me përjashtim të atyre që kanë të bëjnë me çështje të interesit publik, i padituri do të ketë barrën e provave për të dëshmuar vërtetësinë e deklaratës së tij dhe konstatimi nga gjykata se një nga deklaratat e fakteve që vihen në dyshim është në thelb e vërtetë e përjashton të paditurin nga çdo përgjegjësi"*.

Me nenin 182 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcaktohet se *"Në rast të cenimit të së drejtës së personalitetit gjykata mund të urdhërojë shpalljen e aktgjykimit, përkatësisht të përmirësimit me shpenzim të dëmtuesit, ose të urdhërojë që dëmtuesi të tërheq deklaratën me të cilën është bërë shkelja, ode diç tjetër me të cilën gjë mund të realizohet qëllimi që arrihet me shpërblim"*.

Kushtetuta e Kosovës, Neni 40 [Liria e Shprehjes], paragrafi 1 ka përcaktuar se *"Liria e shprehjes është e garantuar. Liria e shprehjes përfshin të drejtën për të shprehur, për të shpërndarë dhe për të marrë informacione, mendime dhe mesazhe të tjera, pa u penguar nga askush"*. Paragrafi 2 ka paraparë se *"Liria e shprehjes mund të kufizohet me ligj në raste kur një gjë e tillë është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare"*.

Neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), (e zbatueshme drejtpërdrejtë sipas Nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës), ka paraparë se: (1) *Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që t'u kërkojnë ndërmarrjeve të transmetimit audioviziv, televiziv ose kinematografik të pajisen me licencë.* (2) *Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor"*

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike, përkatësisht secilës prej provave veç e veç e të gjitha së bashku, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, andaj dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë për arsyet që do të elaborohen në vazhdim të këtij arsyetimi.

Siç edhe është theksuar më lartë, nuk ishte kontestuese as nga i padituri se i njëjti me datë 21.07.2018, e ka dhënë deklaratën ne televizionin ..., e sipas paditësit i njëjti ka shpifur ndaj tij. Gjykata vlerësoi se i padituri me këtë deklaratë ka konsumuar elementet e shpifjes ndaj paditësit, pasi që me asnjë provë nuk e ka vërtetuar se paditësi i ka thënë “ thënë t’i ski çka na bën, se unë e kam djalë të tezes Sh.M , është fakt se ky më ka thënë edhe më ka kërcënuar edhe në market, kur kam shkuar për të blerë gjëra ushqimore për fëmijë, aty më ka pritur edhe më ka përcjellë deri jam dalë prej aty dhe më ka thënë unë i kam njerëzit e mi në polici dhe ti nuk mundesh kurrëgjë me bë”. Pra i padituri i cili e ka barrën e provës në këtë rast, nuk e ka dëshmuar vërtetësinë e deklaratës së lartcekur të tij.

Tutje, pretendimet e të paditurit se ka qenë i frikësuar, kërcënuar dhe sulmuar nga paditësi, gjykata i vlerësoi si të pabazuara dhe të paargumentuara. Dorëzimi nga i padituri në cilësi të provave i Aktgjykimit me urdhër ndëshkimor i GJTHM- Dega në Vushtrri, P.nr.476/19 i datës 14.01.2020 dhe Aktgjykimit me urdhër ndëshkimor i GJTHM- Dega në Vushtrri, P.nr.476/19 i datës 25.06.2021, e përmes së cilave ka pretenduar se paditësi H.T , është dënuar për ndonjë vepër penale të kryer ndaj tij, nuk vërtetuan se paditësi e ka sulmuar apo kërcënuar të paditurin.

Po ashtu deklarimi i të paditurit lidhur me problemet me familjen Sh., të dhënë në televizionin ..., e që i referohet kohës kur ka pretenduar se ka qenë i sulmuar nga paditësi, e rrjedhimisht në kohën kur ka qenë duke u zhvilluar procedura penale ndaj familjes Sh., nuk është rrethanë që do ta përjashtonte të paditurin nga përgjegjësia për shpifje, respektivisht nëse deklarata e tij do të gjente mbështetje ligjore, në nenin 9 ku përcaktohet se “ *Deklaratat e dhëna nuk bartin përgjegjësi në bazë të këtij Ligji nëse i padituri dëshmon se ato janë bërë në cilën do nga rrethanat në vijim: c) çdo deklaratë e bërë gjatë çdo faze të procedurave paragjyqësore, gjyqësore ose administrative, nga cilido që është përfshirë direkt në këtë procedurë, përveç rasteve kur provohet se deklarata në fjalë nuk lidhet fare me procesin gjyqësor, pasi që paditësi nuk ka qenë i përfshirë në këto procedura.*

Në vlerësimin e gjykatës, pretendimi i paditësit se nga deklarimi i të paditurit, ka përjetuar dëm jo material, për shkak të cenimit të personalitetit të tij, paraqet bazë për shpërblimin e dëmit dhe

i padituri duhet të mbahet përgjegjës për shpifjen, pasi që ekziston edhe lidhja kauzale në mes të veprimit të të paditurit dhe dëmit të shkaktuar paditësit.

Gjykata vlerëson se shuma e gjykuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke marrë për bazë edhe praktikën gjyqësore të gjykimit ta kompensimit të dëmit jo material që ndërlidhen me baza tjera të përgjegjësisë, erdhi në përfundim se në rastin konkret shuma e gjykuar në emër të kompensimit për dëmin jo material si pasojë e shpifjes ndaj paditësit në proporcion me të mirat që i janë cenuar nga personaliteti dhe integriteti i tij personal dhe familjar, duhet të jetë shuma prej 1,300 euro, shumë kjo e cila sipas vlerësimit të kësaj gjykate e dhënë në formë të satisfaksionit të paditësit për dëmin e pësuar moral në formë të kompensimit në të holla është ekuivalente dhe do të riparohet në masë të konsiderueshme pasojat e shkaktuara emocionale tek i njëjti me deklarinimin e pavërtetë të të paditurit.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë në shumën prej 700.00 euro, që ndërlidhet me dëmin jo material, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar prej 1,300.00 euro, nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë dhe të mos favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.

Për kamatën, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 par.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nr. 04/L-077 dhe pikës XV të Mendimit Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës, Nr.265/2020 të datës 02.12.2020.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform nenit 449 par.1 dhe 452 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara, i referohen taksës për padi në shumën prej 30 euro, për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro dhe për përfaqësim në dy seanca shumën prej 270 euro, përkatësisht shumën totale prej 404 euro.

Andaj, bazuar në të lartcekurat dhe konform nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil

C. nr.436/18, me datë 30.05.2024

Numri i lëndës: 2019:232352
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05755409

Gj y q t a r i
Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.